



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA

Nr./Br. 01/1734/19

Nr./fa./Pratr. _____

Data/Datum: 02.08.2019

PRISHTINË-PRISHTINA



Me qëllim të bashkëpunimit në ngritjen e kapaciteteve profesionale, organizative dhe shkencore në fushën e Gjeodezisë, Kadastrit, Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Hartografisë dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor, Agjencia Kadastrale e Kosovës (këtu e referuar si AKK) dhe Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës (këtu e referuar si SHGJK), nënshkruajnë këtë:

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

nëpërmjet të cilit e vendosin interesin e përbashkët të bashkëpunimit në fushën e Gjeodezisë, Kadastrit, Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Hartografisë dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor.

Bashkëpunimi i nënshkruarve të Memorandumit në fushat e përcaktuara përfshinë:

Neni 1

1. Përfshirja e SHGJK-së, në grupet punuese për hartimin e legjislacionit, udhëzimeve administrative, kornizave të punës dhe doracakët për punë teknike që rregullojnë fushën e gjeodezisë, kadastrit, dhe regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme;
2. Organizimi i përbashkët i seminareve, punëtorive dhe tryezave profesionale, për të prezantuar dhe diskutuar eksperiencat më të mira në fushën e gjeodezisë, kadastrit, dhe regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme;
3. AKK mundëson për SHGJK-në këndin e informimit në gazetën periodike "KADASTRA", e menaxhuar nga AKK-ja;
4. Kontribut dhe pjesëmarrje profesionale e AKK-së, në gazetën e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës;
5. Për koordinim më efikas, AKK-ja të përfaqësohet në takimet e Kryesisë së SHGJK-së;
6. Koordinimi i aktiviteteve dhe paraqitja e përbashkët para organizatave ndërkombëtare profesionale, përmes përfaqësimit të interesave të përbashkëta;
7. Mbështetja dhe bashkëpunimi për themelimin e Odës së Gjeodetëve të Kosovës
8. Koordinimi dhe bashkëpunimi në ngritjen e kapaciteteve organizative, profesionale dhe shkencore të segmenteve të cilat janë në interes të përbashkët;
9. Aktivitete të tjera me interes të përbashkët për të dy nënshkruarit e memorandumit;

Neni 2

Nënshkruarit e memorandumit do të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe do të inkurajojnë zbatimin e angazhimeve të përbashkëta në pikat e renditura në Nenin 1 të këtij memorandumit, sipas kompetencave të tyre dhe ligjeve në fuqi.

Neni 3

Për të monitoruar zbatimin e këtij memorandumit, për të propozuar aktivitete të reja dhe për të dhënë udhëzime për zbatimin e tyre, nënshkruarit e memorandumit do të takohen dy (2) herë në vit.

Neni 4

Ky memorandum nënshkruhet për një periudhë pesë (5) vjeçare.

Secila palë mund ta ndërpresë këtë memorandum në çdo kohë, me një letër të shkruar të dërguar palës tjetër tre (3) muaj para ndërprerjes.

Ndërprerja e memorandumit nuk do të ndikojë në përfundimin e aktiviteteve të dakorduara me memorandum të filluara para datës së ndërprerjes së memorandumit, përveç nëse palët bien dakord ndryshe.

Neni 5

Ky memorandum mund të ndryshohet dhe të plotësohet me pëlqim të ndërsjellë me shkrim të palëve.

Neni 6

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e zbatimit të këtij memorandum do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve të përbashkëta dhe negociatave ndërmjet palëve.

Neni 7

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 02.08.2019

DREJTOR EKZEKUTIV:

AGJENCIA KADASTRALE E
KOSOVËS




Avni AHMETI

KRYETAR:

SHOQATA E GJEODETËVE TË
KOSOVËS




Murat HOXHA